

Java Kulturore Japoneze

12-18 Tetor



Java **Kulturore**
Japoneze

12 Tetor

ORA: 10:00

KUPA E AMBASADORIT NË XHUDO DHE KARATE

Aktivitet që sjell emocionin e arteve marciale japoneze – Xhudo dhe Karate. Sportistë të rinj shqiptarë garojnë në një shfaqje mbresëlënëse të aftësisë dhe atletizmit.

PARKU OLIMPIK – TIRANË

Java **Kulturore**
Japoneze

13 Tetor

ORA: 17:00

ZBULONI JAPONINË: SEMINAR MBI TURIZMIN

Seminar informues mbi turizmin në Japoni nga Organizata Kombëtare e Turizmit e Japonisë. Pjesëmarrësit do të njihen me informacionet kryesore për planifikimin e një udhëtimi në Japoni, si dhe do të kenë mundësinë të përjetojnë një “shije” autentike të kulturës japoneze.

COD – QENDRA PËR HAPJE DHE DIALOG – TIRANË

Java **Kulturore**
Japoneze

14 – 15 Tetor

ORA: 17:00

SHIJA E TRADITËS: CEREMONIA JAPONEZE E ÇAJIT

Eventi ofron një përvojë në artin e ceremonisë tradicionale japoneze të çajit, i udhëhequr nga një Mjeshtër Japonez i Çajit. Pjesëmarrësit do të mësojnë rreth ritualit dhe do të kenë mundësinë të shijojnë çajin matcha, i njohur dhe i vlerësuar në Shqipëri dhe jashtë saj. Secila seancë ka maksimumi 35 pjesëmarrës.

VILA 31 ART EXPLORA – TIRANË

Java **Kulturore** Japoneze

14 – 18 Tetor

14-15-16 TETOR | ORA 20:00
17-18 TETOR | ORA 19:00

JAVA E FILMIT JAPONEZ

Kinemaja japoneze nuk është vetëm Anime! Njihuni me kryeveprat e fundit të kinemasë japoneze.

PROGRAMI I FILMAVE:

14 Tetor: “The Lines That Define Me” nga Norihiro Koizumi

15 Tetor: “MONDAYS: See you 'this' week!” nga Ryo Takebayashi

16 Tetor: “Neko Ninja” nga Takeshi Watanabe

17 Tetor: “Between Us” nga Yasuo Okuaki

18 Tetor: “Takano Tofu” nga Mitsuhiro Mihara

Ky cikël filmash ofron mundësinë për të eksploruar stilin dhe temat e ndryshme të kinemasë japoneze moderne përtej animacionit.

QENDRA E ARTIT “AGIMI” – TIRANË

Java **Kulturore**
Japoneze

16 Tetor

ORA: 17:00

UDHËTIM KULINARIK NË JAPONI

Demonstrim i Washoku-së (ushqimit japonez) që prezanton artin tradicional të përgatitjes së mochi-t (tortë orizi) dhe gatimeve të tjera tipike. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të mësojnë procesin e përgatitjes së mochi-t dhe të shijojnë shijet autentike japoneze. Secili sesion ka maksimumi 50 pjesëmarrës.

VILA 31 ART EXPLORA - TIRANË